REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIK OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika, nenit 16 ,17 c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit nr. 03/l-049 për Financat e Pushetit Lokal dhe nenit 20 paragrafi.1 i Statutit të Komunës së Lipjanit, 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 28.02.2025, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM
PËR LIRIMIN NGA PAGESA E BORXHEVE TË QIRASË JOPROFITABILE TË PËRFITUESVE TË BANIMIT SOCIAL

Neni 1

LIROHEN , nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të gjithë përfituesit e banimit social që janë të vendosur në **31 (tridhjetë e një) banesat** e ndara nga Komuna për periodën prej datës 01.01.2025 deri me datë 31.12.2025.

Neni 2

Lirimi nga pagesa e borxheve për përfituesit e banimit social të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi bëhet me qëllim të krijimit të lehtësirave financiare për këto familje me gjendje të rëndë ekonomike për shkak të situatës së rënduar në ekonominë e vendit si pasojë e rritjes së lartë të çmimeve të të gjithë artikujve elementarë jetësor.

Neni 3

Qiraja joprofitabile është llogaritur në bazë të formulës së përcaktuar me dispozitat e nenit 9 të Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit për secilin përfitues dhe mjetet që inkasohen nga qiraja janë të hyra vetanake dhe regjistrohen në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim në kodin 21/613/48003/50408/00000/0411 .

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyra e Kryetarit të Komunës – Sektori Pronësor - Juridik.

.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 15-360/01-9561
Lipjan, më 28.02. 2025

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi